



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Nr.109/26

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT – PRIZREN

Datë: 29.01.2026

Raport i punës për periudhën janar – dhjetor 2025

Në këtë raport janë pasqyruar aktivitetet, projektet dhe punët e kryera në DKA në periudhën janar – dhjetor 2025.

Hyrje

Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren në përputhje me Planin Dinamik të saj për periudhën janar – dhjetor 2025, dhe bazuar në planifikimin e sektorëve në DKA mbi detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarëve, ka planifikuar dhe realizuar aktivitete dhe projekte të ndryshme.

Në këtë raport përfshihen punët administrative, monitorimi dhe mbikëqyrja e shkollave, shënimi i rekomandimeve për shkollat, shënime të përgjigjeve dhe vendimeve për transferimin e nxënësve të shkollave mesme të larta, organizimin e arsimit joformal, procedurat e ndërtimit të objekteve shkollore, anekseve, riparimeve, mirëmbajtjen e objekteve dhe ambienteve shkollore, projektet që lidhen me sigurinë në shkolla, planifikimin e buxhetit për çdo fillimviti shkollor, shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve etj.

Raporti për periudhën janar – dhjetor 2025 është përpiluar nga raportet e aktiviteteve, projekteve të realizuara dhe punë tjera të kryera nga kjo drejtori, gjatë kësaj periudhe. Në këtë raport janë përmbledhur të dhënat e sektorit të arsimit dhe të administratës, punëtoritë e zhvilluara dhe aktivitete të tjera të cilat janë mbajtur.

1. Udhëheqja dhe menaxhimi i shkollave

Qeverisje, udhëheqje dhe menaxhim cilësor në të gjitha institucionet edukative-arsimore të komunës.

Raporti mbi të arriturat

Në Janar 2025 është mbajtur trajnimi i drejtorëve (7 ditor) për ngritjen e kapaciteteve për Udhëheqje dhe Menaxhim për të gjithë drejtorët e institucioneve shkollore në Prizren përmes moduleve nga programe të akredituara nga MASHTI.

Për fuqizimin dhe funksionalizimin e Këshillave Drejtues të Shkollave është mbajtur trajnim profesional me KDSH, me qëllim të mbështetjes profesionale në mënyrë kontributi të jetë sa me profesional varsishtë nga specifikat e shkollave.

Në maj 2025 është mbajtur punëtori me drejtues të shkollave, sekretar, psikolog e anëtarë të këshillit të prindërve për “Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinnor në Arsim në Komunën e Prizrenit” me qëllim t’i bëjmë shkollat tona mjedise miqësore, të përshtatshme dhe të sigurta për nxënësit dhe nxënëset, mësime dhënësit dhe mësime dhënëset dhe për të gjithë të tjerët.

Në kuadër të projektit “**Avancimi i cilësisë së arsimit në Komunën e Prizrenit - Ngritja e kompetencave përmes zhvillimit profesional në fushën e menaxhimit, vlerësimeve, mendimit kritik dhe gjithëpërfshirjes**” është realizuar Studimi Rapid i Shkollave - hulumtim profesional i gjendjes aktuale në secilën shkollë duke përfshirë nivelin e menaxhimit, resurset humane, administratën, infrastrukturën, vizionin, raportet ndërkolegiale, aktivitet profesional, organet qeverisëse të shkollës, etj me qëllim që të kemi skanim real të gjendjes.

Janë hartuar raporte individuale në nivel shkolle dhe raporti përmblendhës në nivel komune, si dhe janë dhënë rekomandime konkrete me qëllim të avansimit të arsimit në nivel komune.

Poashtu, me qëllim të menaxhimit dhe efikasitetit nëpër shkolla është bërë rishikimi dhe racionalizimi i rrjetit të klasave në shkolla në Komunën e Prizrenit.

2. Kultura dhe Mjedis

Mjedis shkollor i përshtatshëm për zhvillimin e procesit mësimor dhe aktiviteteve jashtë mësimore.

Raporti mbi të arriturat

Nga muaji prill 2025 ka hy në fuqi “**Strategjia për sigurinë në institucionet edukativo – arsimore**” e cila është plan i përbashkët për të garantuar një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm për nxënësit, mësuesit dhe stafin arsimor. Kjo strategji synon të parandalojë rreziqet, t’i minimizojë incidentet dhe të promovojë një kulturë të mirëqenies në shkollë.

Gjatë gjithë vitit ka vazhduar puna me ndërtimin e terreneve dhe Sallave të Edukatës Fizike në shkolla dhe furnizimi me pajisje edukativo – sportive. Poashtu, është punuar edhe në rregullimin e ambienteve të jashtme të shkollave për të ofruar mjedis shkollor sa më të përshtatshëm për zhvillimin e procesit mësimor dhe aktiviteteve jashtë mësimore.

3. Mësimdhënia dhe Nxënia,

Përmirësim domethënës i cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënësve në shkollë.

Raporti mbi të arriturat

DKA në bashkëpunim me shkollat e komunës dhe OJQ që mirren me arsim ka punuar në fuqizimin e modelit "komuniteti i të mësuarit së bashku".

Shkollat janë furnizuar me mjete të TIK-ut nga DKA dhe me mjete elementare të konkretizimit nga bashkëpunorët e arsimit.

Gjatë vitit ka vazhduar pajisja e shkollave me laboratorë të ndryshëm të cilët ndikojnë drejtpërdrejt në efektivitet të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Organizimi mësimi plotësues dhe trajnimeve për nxënësit ndikon drejtpërdrejt në ngritjen e cilësisë në arsim. DKA në bashkëpunim me Flutura Academy dhe OJQ që mirren me fushën arsimore po vazhdon mbajtjen e trajnimeve për nxënësit në fushën e IT-së dhe gjuhëve të huaja.

Poashtu, janë mbajtur shumë aktivitete jashtëkurrikulare të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në procesin e cilësisë në arsim.

4. Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja

Bashkëpunim cilësor dhe efikas në mes të hisedarëve të edukimit parashkollor.

Raporti mbi të arriturat

Është përgatitur drafti i "Planit të Veprimit kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit në Shkollë", ku së shpejti pritet të del draft dokumenti në dëgjim publik.

Po vazhdon procesi i identifikimit të institucioneve parashkollore private. Janë mbajtur disa takime koordinuese me Inspektoratin e Arsimit, ku janë duke u koordinuar vizitat dhe mbledhja e të dhënave nga institucionet arsimore.

Bashkë me agjensitë zhvillimore është duke vazhduar përkrahja e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore. DKA ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Caritas Kosova për të vazhduar në dhënien e shërbimeve profesionale psikologjike për fëmijët me nevoja të veçanta. Gjithashtu vazhdon bashkëpunimi edhe me organizatat e tjera ndërkombëtare (Unicef, SCIK etj) për t'i përmirësuar shërbimet arsimore për nxënësit në nevojë.

Është funksionalizuar institucioni i edukimit të hershëm "Dielli Ynë" në lagjen Bajram Curri. Jemi në fazën finale të përgatitjeve për hapjen e Institucionit për edukim të hershëm në lagjen Ortakoll në Prizren.

Përmes garave dhe aktiviteteve të tjera ndërkulturore, është duke u promovuar multikulturalizmi dhe diversiteti në arsimin parauniversitar.

5. Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve

Ndërtimi i vazhdueshëm i kapacitetit për mësimdhënie cilësore.

Raporti mbi të arriturat

Zhvillimi profesional i mësimdhënësve është një nga faktorët kryesorë që ndikon drejtpërdrejt në ngritjen e cilësisë në arsim. DKA në vazhdimësi ka hulumtuar kërkesat e menaxhmentit udhëheqës të institucioneve edukative e arsimore dhe të mësimdhënësve për zhvillim profesional. Prandaj, nga kërkesat e shkollave është vlerësuar se fillimisht zhvillimi profesional do të orientohet në fushat e menaxhimit, vlerësimit, mendimit kritik dhe gjithëpërfshirjes. Prandaj, me qëllim që mësimdhënësit të jenë sa më të përgaditur, DKA ka organizuar trajnime për mbi 500 mësimdhënës, të ndarë në fushat përkatëse:

- Vlerësimi Formativ – mësimdhënës (7 grupe),
- Mendimi Kritik – mësimdhënës (4 grupe),
- PIA – mësimdhënës (4 grupe).

Trajnimet e ofruara janë nga programet e akredituara nga MASHTI dhe valide për procesin e licensimit apo rilicensimit të mësimdhënësve.

6. Përmirësim i vazhdueshëm i cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit në shkolla

Fuqizimi i aktiveve profesionale në shkolla me mbështetje profesionale.

Raporti mbi të arriturat

Fuqizimi i aktiveve profesionale në shkolla, përkrahja e koordinatorëve të cilësisë me bazë në shkollë, ndërtimi, renovimi, zgjerimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës shkollore si dhe furnizimi ka ndikuar dukshëm në përmirësimin e cilësisë në të nxënit.

Ndërtimi i vazhdueshëm i kapaciteteve dhe i mekanizmave për zbatim dhe monitorim të kurrikulës së re.

Është intensifikuar shërbimi i këshillëdhënies për shkollat lidhur me zbatimin e KKK. Përmes drejtorëve dhe koordinatorëve të cilësisë shkollat marrin këshilla nga DKA për modalitetet e zbatimit të KKK, për sfidat e zbatimit dhe për zgjidhjet e mundshme të problemeve ad-hoc të zbatimit të KKK. Gjithashtu, shkollat vazhdimisht furnizohen me materiale pune, me udhërrëfyes dhe dokumentacion relevant për zbatimin e KKK.

Megjithatë është duke u shtuar përdorimi i mjeteve digjitale në funksion të mësimdhënies dhe nxënies, shkollat janë furnizuar me tabela të mençura si dhe me paisje teknologjike. Ka filluar faza e parë e digjitalizimit të sistemit arsimor (platformës digjitale).

Me bashkëfinancim me IOM tri shkolla janë pajisur me kabinete fizik, kimi, biologji, gjeografi bazuar në nevojat e shkollave.

Me mbështetje nga Super Viva në Pizren është realizuar projekti i atelies së artit figurativ në ShFMU "Mustafa Bakiu" në Prizren.

Për vitin shkollor 2024-2025 Drejtoria Komunale e Arsimit ka rritur numrin e bursave. Këtë vit nga 170 bursa sa ishte vitin e kaluar në është bërë në 250 bursa në vlerë prej 700 euro.

Po ashtu për vitin shkollor Drejtoria Komunale e Arsimit ka ndarë bursa nga 300 euro për nxënës të shkollave të mesme për fëmijët e invalidëve të luftës dhe nxënës me nevoja të veçanta,

Të dhënat statistikore

Gjatë vitit shkollor **2025/2026** në institucionet publike të menaxhuara nga Komuna e Prizrenit kanë ndjekur mësimin **26.920** nxënës, të gjitha shkollat publike me paralelet e ndara, në të tri nivelet e arsimit (0, 1, 2 dhe 3) nga edukimi i herëshëm (fëmijë të moshave 3-4 vjeç) deri në shkollat e mesme të larta (klasa e 12), janë si në tabelarin e mëposhtëm.

Numri i nxënësve në Komunën e Prizrenit Viti 2025													
Niveli i edukimit të hershëm		Niveli fillor					Niveli i mesëm i ulët					Niveli i mesëm i lartë	
Parashkollorë (Mosha 3-4 vjeç dhe 4-5 vjeç)	Parafillorë	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
870	1710	1971	2040	2103	2000	2039	2008	2122	1971	2136	2103	2007	1840
													Gjithsej 26.920
Në nivelin e edukimit të hershëm (mosha 3-5 vjeç dhe mosha 5-6 vjeç)												2.580	
Në nivelin fillor (Klasa I - V)												10.153	
Në nivelin e mesëm të ulët (Klasa VI – IX)												10.340	
Në nivelin e mesëm të lartë (Klasa X – XII)												03.847	
Për të gjitha nivelet												Totali	
												26.920	

Struktura e të punësuarëve në arsim në Prizren në vitin shkollor 2025/26

Nr.	KUADRI	SHQIP		BOSHNJ		TURQ		ROM		GJITHSEJ		GJITHSEJ
		M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	
1	EDUKATOR	1	67	/	9	/	6	/	3	1	85	86
2	MËSUES (I -V)	101	397	52	22	1	32	1	1	155	452	607
3	ARSIMTAR (VI-IX)	361	334	80	30	15	21	/	/	456	385	841
4	MËSIMDHËNËS (X-XII)	162	112	19	13	11	13	/	/	192	138	330
5	DREJTOR	36	18	6	1	/	/	/	/	42	19	61
6	ZV.DREJTOR	3	2	/	/	3	/	/	/	6	2	8
7	SEKRETAR	11	10	/	/	/	/	/	/	11	10	21
8	PSIKOLOG	1	7	/	/	/	/	/	/	1	7	8
9	PEDAGOG	5	2	/	/	/	/	/	/	5	2	7
10	BIBLIOTEKIST	5	6	/	/	/	/	/	/	5	6	11
11	STAF MBËSHTETES	193	21	20	8	11	1	/	7	221	41	262
	TOTALI	879	977	179	86	35	77	14	23	1107	1163	2270

Arsimi i komuniteteve

Në mënyrë periodike takohen drejtorët e shkollave të komuniteteve dhe shkollave në të cilat zhvillohet mësimi edhe në gjuhët e komuniteteve. Një ndër shqetësimet kyçe të këtyre shkollave janë librat mësimorë në gjuhën e komuniteteve, të cilat nuk janë përgatitur me kohë nga MASHTI, gjë që vështirësojnë punën e mësimdhënësve me nxënësit. Deri në pajisjen me materialet mësimore shkollat janë udhëzuar të përdorin burime alternative nga interneti.

AKTIVITETET:

- 7 Marsi - Është organizuar program artistik nga DKA për nder të ditës së mësuesit, ku janë shpërndarë mirënjohje, dhurata dhe i është dhënë një drekë mësimdhënësve që kanë dalë në pension;
- Janë mbajtur Garat Komunale Fizikanit te Ri 2025,
- Është mbajtur testi ndërkombëtar PISA 2025 nga 18 shkolla në Komunën e Prizrenit, kanë marrë pjesë 606 nxënës në testin PISA;
- Testi i Arritshmërisë – është mbajtur Testi i Arritshmërisë për vitin shkollor 2024-2025 me datën 28 qershor 2025.
- Testi i Maturës – Përgatitja e organizimit të Testit të Maturës për vitin shkollor 2024/2025, i cili është mbajtur me datën 21 qershor 2025 afati parë dhe 28 gusht 2025.
- Vizita në të gjitha shkollat e mesme të Larta për të monitoruar dokumentet pedagogjike dhe administrative.

Trajnime, punëtori dhe punë në ekip

- Punëtori për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor 2026-2028;
- Pjesëmarrje në punëtorinë për të drejtat e fëmijëve;
- Takim i komisionit për komunitetin Romë – Ashkali – Egjiptian, pranë kuvendit komunal;
- Organizimi i procesit mësimor në mësimin jo formal.
- Mbikëqyrja e planeve të punës dhe procesit edukativo - arsimor; kontrollimi i funksionimit të organeve të shkollës etj;
- Bashkëpunimi me prindër, Ekipet e EPRBM të shkollës, këshilli i prindërve dhe këshilli i nxënësve;
- Monitorimi i shkollave për të kontrolluar plotësimin e standardeve për krijimin e mjedisit gjithëpërfshirës të përshtatshëm të mësimdhënies dhe të nxënësve;
- Vlerësimi i brendshëm i shkollës në shkallë kurrikulare – “Monitorimi i nxënësve të shkollave të komunës së Prizrenit;
- Kontrollimi i vlerësimit të brendshëm të shkollave;
- Monitorimi i funksionimit të mjeteve teknologjike i shkollave;

Infrastruktura në shkollat e komunës

Njësia teknike pranë DKA-së ka vazhduar punët edhe në këto 6 mujorin e dytë të vitit 2025 me realizimin e projekte dhe planifikimin e projekteve të reja, përfshirë furnizimin me mallra dhe dhënie të shërbimeve të shkollave, si dhe ka monitoruar punimet (nga investimet kapitale) që janë bërë në ndërtimin e objekteve shkollore. Janë realizuar aktivitetet e ndryshme si vijon:

- Kompletimi dhe dorëzimi i dokumentacionit të inventarizimit të shkollave dhe DKA-së tek zyrtarët në Drejtorinë e Financave,
- Vizitat e rregullta nëpër shkolla për verifikimin e pastërtisë dhe higjienës,
- Vizita të rregullta në çerdhen e fëmijëve për të evidentuar kërkesat lidhur me infrastrukturë dhe mallëra.
- Janë mbajtur takimet konsultative me operatorët ekonomikë – punëkryesit lidhur me ndërtimin e objekteve shkollore.
- Janë mbikëqyrë punimet e projekteve të cilat vazhdojnë nga vitet e kaluara.

Vërejtje: Në fillim duhet të cekim se nga proceset përmbartimore, prej buxhetit të investimeve kapitale-grantit, janë marrë **600,000.00€**, në projektet e mëposhtme:

1. Ndërtimi i qerdhes ne Lagjen Arbana Prizren – **100,000.00€**
2. Digjitalizimi i sistemit te institucioneve arsimore – **100,00.00€**
3. Renovimi i objektit shkollor SHMU "Hysen Rexhepi" – **100,000.00€**
4. Renovimi i objektit shkollor ne Fshatin Gjonaj (objekti i vjeter) – **100,00.00€**
5. Ndertimi i Salles se Edukates Fizike ne SHMU Gani Saramati-projekt tre vjeçar – **50,000.00€**
- 6* Ndertimi I depose per lende djegese per ngrohje ne SHFMU "Leke Dukagjini" Prizren dhe "Mushnikova" Mushnikovë – **50,000.00€**
- 7* Renovimi i teresishem i objektit shkollor "Deshmoret e Zhurit" Zhur - **50,000.00€**
- 8* Renovimi I objektit shkollor "Mustafa Bakia" Prizren - **50,000.00€**

Sa i përket Investimieve Kapitale të planifikuara për vitin 2025, ato janë në fazat si më poshtë:

1. Ndërtimi i qerdhes në Lagjen Tusus Prizren (vlera e kontratës dhe aneks kontratës 1,326,313.45€)

(Mjetet e planifikuara për vitin 2025 në vlerë prej 250,000.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 250,000.00€ / 100% realizim)

Deri më tani janë realizuar punimet e vrazhda (shtylla, traje, mure dhe pllaka) të bodrumit, përdhësës dhe etazhës, të gjitha niveleve të objektit. Për momentin, punimet janë duke vazhduar sipas planifikimit të buxhetit.



2. Ndërtimi i objektit të ri shkollor "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" (ish Pjeter Mazrreku) në Mazrrek, (vlera e kontratës dhe aneks kontratës 746,800.73€)

(Mjetet e planifikuara për vitin 2025 në vlerë prej 376,800.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 746,800.73€ / 100.00% realizim)

Punimet kanë përfunduar dhe është bërë pranimi teknik i punimeve dhe objekti është funksionalizuar. Pagesa përfundimtare është realizuar sipas planifikimit buxhetor për investime kapitale.



3. Ndërtimi i objektit të ri shkollor në Krushe të Vogël (vlera e kontratës dhe aneks kontratës 491,046.38€)

(Mjetet e planifikuara për vitin 2025 në vlerë prej 38,661.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 38,661.00€ / 100.00% realizim)

Punimet kanë përfunduar dhe është bërë pranimi teknik i punimeve dhe objekti është funksionalizuar. Pagesa përfundimtare është realizuar sipas planifikimit buxhetor për investime kapitale.



4. Ndërtimi i aneksit të shkollës në Vërmicë (vlera e kontratës dhe aneks kontratës 377,195.49€)

(Mjetet e planifikuara për vitin 2025 në vlerë prej 53,865.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 53,862.60€ / 99.99% realizim)

Punimet kanë përfunduar dhe është bërë pranimi teknik i punimeve dhe objekti është funksionalizuar gjatë vitit 2024. Pagesa përfundimtare është realizuar gjatë muajit shkurt të vitit 2025 sipas planifikimit të buxhetit.



5. Ndërtimi i aneksit të shkollës "Besim Ndrecaj" Lutogllavë (vlera e kontratës 399,002.98€)

(Mjetet e planifikuara për vitin 2025 në vlerë prej 100,000.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 75,000.00€ / 75.00% realizim)

Deri më tani janë realizuar 85-90% e punimeve. Për momentin punimet janë duke vazhduar dhe përkundër mungesës së mjeteve financiar, objekti të funksionalizohet deri në fund të vitit 2025. Mbetja e pagesës përfundimtare do të realizohet në fillim të vitit 2026, sipas planifikimit buxhetor për vitin 2026.



6. Renovimi i objektit shkollor SHF "Lekë Dukagjini" Prizren

(vlera e kontratës dhe aneks kontratës 211,328.76€)

(Mjetet e planifikuara për vitin 2025 në vlerë prej 16,800.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 15,845.81€ / 94.32% realizim)

Të gjitha punimet janë realizuar dhe është bërë pranimi teknik gjatë vitit 2024 ndërsa pagesa përfundimtare është realizuar në shkurt të vitit 2025 sipas planifikimit.



7. Rregullimi i ambientit të oborreve në shkollat e Prizrenit

(vlera e kontratës kornizë 1,500,00.00€)

(Mjetet e planifikuara për vitin 2025 në vlerë prej 141,630.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 141,630.00€ / 100.00% realizim)

Projekti 3 vjeçar, i ka filluar së implementuari. Deri më tani janë realizuar punimet në rregullimin e ambienteve të oborreve në shkollat “Vëllezërit Frashëri” në Planëjë - Has, janë duke u punuar në shkollat “Emin Duraku” në Prizren dhe “Haziz Tola” Prizren, “Fadil Hisari” Prizren, “Naim Frashëri” Vlashne dhe janë duke punuar në shkollën “Pjetër Budi” Lubizhdë-Has. Kontrata është 3 vjeçare dhe do të realizohet sipas planifikimit të DKA-së, nëpër shkolla.

8. Ndërtimi i çerdhes në Fshatin Zhur Prizren (vlera e kontratës 633,300.00€)

(Mjetet e planifikuara për vitin 2025 në vlerë prej 50,000.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 00.00€ / 0% realizim)

Projekt 3 vjeçar, i planifikuar të filloj nga muajt nëntor-dhjetor të vitit 2025. Kontrata e saponëshkruar dhe posa të paisemi me lejen ndërtimore do të fillojnë punimet. Punimet sipas kontratës dhe planifikimi i buxhetit, do të zgjasin deri në vitin 2028.

9. Ndërtimi i çerdhes në Lagjen Arbana Prizren (vlera e kontratës 0,00€)

(Mjetet e planifikuara për vitin 2025 në vlerë prej 100,000.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 00.00€ / 0% realizim)

Projekt 3 vjeçar, i planifikuar të filloj nga viti 2025. Projekti për momentin është në pritje të rregullimit të çështjeve pronësore juridike, e më pastaj të vazhdohet me hartimin e projektit zbatues dhe marrjes së lejes ndërtimore.

Punimet, varësisht nga vlera dhe planifikimi i buxhetit, do të zgjasin deri në vitin 2028.

10. Renovimi i tërësishëm i obj.shk. "Mati Logoreci" Prizren (vlera e kontratës 464,464.46€)

(Mjetet e planifikuara për vitin 2025 në vlerë prej 150,000.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 00.00€ / 0% realizim)

Projekti 3 vjeçar, i planifikuar të filloj gjatë muajit qershor të vitit 2025.

Për shkak të natyrës së punimeve, ky projekt është planifikuar si projekt 3 vjeçarë dhe kryesisht do të punohet gjatë mujave qershor, korrik dhe gusht të viteve 2025, 2026 dhe 2027.

10. Renovimi i nyjeve sanitare në objektet shkollore: Ibrahim Fehmiu dhe Dëshmorët e Kabashit (vlera e kontratës 124,532.05€)

(Mjetet e planifikuara për vitin 2025 në vlerë prej 74,532.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë të gjitha pagesat)

Projekti i planifikuar ka filluar gjatë vitit 2024 dhe për arsye të natyrës së punimeve, është punuar gjatë muajve qershor, korrik dhe gusht 2025.. Deri më tani janë renovuar nyjet sanitare të SHFMU "Dëshmorët e Kabashit" Korishë dhe një pjesë e nyjeve sanitare në SHFMU "Ibrahim Fehmiu" Lagjja Arbanë Prizren.

11. Renovimi i tërësishëm i sallës së edukatës fizike "Meto Bajraktari" në Reçan (vlera e kontratës 118,108.10€)

(Mjetet e planifikuara për vitin 2025 në vlerë prej 68,109.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 68,108.10€ / 99.99% realizim)

Projekti i përfunduar në fund të vitit 2024. Te gjitha punimet janë realizuar dhe është bërë pranimi teknik, ndërsa pagesa përfundimtare është realizuar në shkurt të vitit 2025 sipas planifikimit.

12. Punimi terrenit sportiv dhe rrethojës së oborrit në SHFMU "Naim Frasheri" Kobaj Prizren (vlera e kontratës 144,738.10€)

(Mjetet e planifikuara për vitin 2025 në vlerë prej 95,000.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 94,738.10€ / 99.73% realizim)

Punimet kanë përfunduar dhe është bërë edhe pranimi teknik në muajin dhjetor të vitit 2024, ndërsa pagesa e fundit është realizuar në shkurt të viti 2025, sipas planifikimit.

13. Digjitalizimi i sistemit të institucioneve arsimore në shkollat; Emin Duraku, Mati Logoreci, Leke Dukagjini, Abdyl Frasheri, Hysen Rexhepi, Gani Saramati, Ibrahim Fehmiu, Fadil Hisari, (vlera e kontratës 0.00€)

(Mjetet e planifikuara për vitin 2025 në vlerë prej 100,000.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 00.00€ / 0% realizim)

Projekti i planifikuar të filloj nga viti 2024 dhe të vazhdoj edhe për vitet 2026 dhe 2027. Projekti për momentin është në fazën e lidhjes së kontratës.

14. Renovimi i objektit shkollor SHMU "Hysen Rexhepi" (vlera e kontratës 0.00€)

(Mjetet e planifikuara për vitin 2025 në vlerë prej 100,000.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 00.00€ / 0% realizim)

Projekti i planifikuar të filloj nga viti 2025, por për shkak të mungesës së mjeteve financiare është shtyer-planifikuar të realizohet gjatë muajve qershor/korrik/gusht të vitit 2026.

15. Renovimi i objektit shkollor ne Fshatin Gjonaj (objekti i vjetër)

(Mjetet e planifikuara për vitin 2025 në vlerë prej 100,000.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 00.00€ / 0% realizim)

Projekt 2 vjeçar, i planifikuar të filloj nga viti 2025. Për momentin janë realizuar vetëm punimet pastrimit të ambientit të jashtëm të objektit. Punimet do të vazhdojnë gjatë viteve të ardhëshme.

16. Ndërtimi i Salles se Edukates Fizike ne SHFMU "Zef Lush Marku" Velezhë (vlera e kontratës 0.00€)

(Mjetet e planifikuara për vitin 2025 në vlerë prej 100,000.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 100,000.00€ / 100% realizim)

Projekt 3 vjeçar. Punimet kanë filluar me gërmime dhe betonime të pjesës së garderobave të objektit. Punimet do të vazhdojnë sipas planifikimit.

17. Ndririmi i kalldajave te ngrohjes qendrore, ne shkollat; SHFMU "Motrat Qiriazi" lagj.Kurile Prizren, "Luigj Gurakuqi" Nashec dhe "Brigada 125" Medvec, (vlera e kontratës 0.00€)

(Mjetet e planifikuara për vitin 2025 në vlerë prej 60,000.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 60,00.00€ / 100% realizim)

Projekti i planifikuar të filloj nga viti 2025. Punimet kanë filluar dhe është bërë ndirimi i kalldajave në shkollat “Luigj Gurakuqi” dhe “Brigada 125”. Në mungesë të mjeteve financiare, ndirimi i kalldajave në shkollën “Motrat Qiriazi” do të bëhet gjatë vitit 2026, sipas planifikimit buxhetor për vitin 2026.

18. Ndërtimi i Salles se Edukates Fizike ne SHMU Gani Saramati (vlera e kontratës 775,000.62 €)

(Mjetet e planifikuara për vitin 2025 në vlerë prej 50,000.00€ nuk janë realizuar pagesat përshkak të përmbarimit)

Projekt 2 vjeçar me bashkëfinancim me MAPL përmes grantit të përfomances. Punimet kanë filluar dhe deri më tani janë realizuar rreth 75% e punimeve ndërtimore të vrazhda, gërmime, betonime shtyllash, pllaka dhe elemente tjera. Poashtu janë realizuar edhe muratime nëpër objekt. Punimet deri ne vlerë 400,000.00€, për pagesë do të mbulohen nga MAPL.

19. Ndërtimi i nyjave sanitare dhe tualeteve ne shkollën Sinan Thaqi ne fshatin Zojz, (vlera e kontratës 25,981.00€)

(Mjetet e planifikuara për vitin 2025 në vlerë prej 30,000.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 25,981.00€ / 100% realizim)

Punimet kanë përfunduar, është bërë pranimi teknik i punimeve dhe objekti është funksionalizuar. Pagesa përfundimtare është realizuar sipas planifikimit buxhetor për investime kapitale.

20. Ndërtimi i aneksit të shkolles "Fatmir Berisha" Prizren

(Mjetet e planifikuara për vitin 2025 në vlerë prej 50,000.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 50,000.00€ / 100% realizim)

Punimet kanë filluar dhe sipas planifikimit të buxhetit punimet, do të zgjasin deri në vitin 2026.

21. Ndërtimi i depozë për lëndë djegëse për ngrohje në SHFMU "Lekë Dukagjini" Prizren dhe "Mushnikova" Mushnikovë

(vlera e kontratës 0.00€)

(Mjetet e planifikuara për vitin 2025 në vlerë prej 50,000.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 00.00€ / 0% realizim)

Projekti i planifikuar të filloj nga viti 2025. Projekti për momentin është në fazën e prokurimit / ankesave.

22. Renovimi i tërësishëm i objektit shkollor "Dëshmorët e Zhurit" Zhur

(vlera e kontratës 723,064.30 €)

(Mjetet e planifikuara për vitin 2025 në vlerë prej 50,000.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 00.00€ / 0% realizim)

Projekt 3 vjeçar. Për shkak të natyrës së punimeve, projekti i planifikuar të filloj gjatë muajve qershor/korrik/gusht të vitit 2026 si dhe të vazhdojë edhe për vitet 2027-2028.

23. Renovimi i tërësishëm i objekti shkollorë në Gorozhup

(vlera e kontratës 42,500.00€)

(Mjetet e planifikuara për vitin 2025 në vlerë prej 33,758.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 33,785.00€ / 100% realizim)

Punimet kanë përfunduar, është bërë pranimi teknik i punimeve dhe objekti është funksionalizuar. Pagesa përfundimtare, e mbetur sipas kontratës, në vlerë prej 8,742.00€ do të realizohet gjatë vitit 2026 sipas planifikimit buxhetor për investime kapitale.

24. Renovimi i objektit shkollor "Mustafa Bakia" Prizren

(vlera e kontratës 42,896.00€)

(Mjetet e planifikuara për vitin 2025 në vlerë prej 50,000.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 00.00€ / 0% realizim)

Për shkak të natyrës së punimeve, projekti i planifikuar të filloj gjatë muajve qershor/korrik/gusht të vitit 2026.

25. Ndërtimi i aneksit të shkollës së mesme në Romajë – Has

(vlera e kontratës dhe aneks kontratës 207,305.42€)

(Mjetet e planifikuara për vitin 2025 në vlerë prej 18,218.00€. Janë realizuar pagesat në vlerë prej 18,218.00€ / 100.00% realizim)

Punimet kanë përfunduar dhe është bërë pranimi teknik i punimeve dhe objekti është funksionalizuar nga muaji shtator i vitit 2024, ndërsa pagesa përfundimtare është realizuar në shkurt të vitit 2025 sipas planifikimit.

Pra gjatë vitit 2025, investime kapitale, janë të planifikuara gjithsej 27 projekte, disa prej të cialve kanë përfunduar gjatë vitit fundvitit 2024. Vlera totale e planifikuara e investimeve kapitale për vitin 2025 është 2,486,873.00€

Sipas rrjedhës së punimeve, gjegjësisht realizimit të tyre, deri me datë 30.11.2025, janë realizuar rreth 97,28%, apo e shprehur në pagesa në euro 2,419,316.70€, por gjithnjë duke patur parasysh 600,000.00€ të shpenzuara për procedurat përmabrimore.

Gjatë vitit 2025 janë në vazhdim nga viti i kaluar edhe këto kontrata/projekte, nga kodi buxhetor mallra dhe shërbime si më poshtë:

1. Hartimi i projektevetë ndryshme për nevojat e DKA, e planifikuara në vlerë prej 100,000.00€. Kontrata është përmbushur 100%, mirëpo ka mungesë buxheti në pagesa. OE i ka marrë mjetet me pëmbërim.
2. Mirëmbajtja e sistemit të ngrohjes qendrore nëpërmjet institucionet arsimore të Komunes së Prizrenit, e planifikuara dhe e kontraktuar në vlerë prej 100,000.00€. Kontrata është përmbushur mbi 100%.
3. Lyerja e brendshme dhe e jashtme (fasadave) të institucioneve arsimore. E planifikuara për tri vite, në vlerë prej 889,750.00€. Deri më tani kontrata është përmbushur rreth 10%, dhe për shkak të mungesës së buxhetit, po kemi vështësi edhe në ekzekutimin e punimeve sipas kontratës.

Pra gjatë vitit 2025, investime kapitale, janë të planifikuara gjithsej 27 projekte, disa prej të cialve kanë përfunduar gjatë vitit fundvitit 2024. Vlera totale e planifikuara e investimeve kapitale për vitin 2025 është 2,486,873.00€

Sipas rrjedhës së punimeve, gjegjësisht realizimit të tyre, deri me datë 31.05.2025, janë realizuar rreth 34,22%, apo e shprehur në pagesa në euro 851,066.61€

Gjatë vitit 2025 janë në vazhdim nga viti i kaluar edhe këto kontrata/projekte, nga kodi buxhetor mallra dhe shërbime si më poshtë:

4. Hartimi i projektevetë ndryshme për nevojat e DKA, e planifikuara në vlerë prej 100,000.00€. Deri më tani kontrata është përmbushur mbi 90%, mirëpo ka mungesë buxheti në pagesa.
5. Mirëmbajtja e sistemit të ngrohjes qendrore nëpërmjet institucionet arsimore të Komunes së Prizrenit, e planifikuara dhe e kontraktuar në vlerë prej 100,000.00€. Deri më tani kontrata është përmbushur mbi 100%, mirëpo ka mungesë buxheti në pagesa.
6. Lyerja e brendshme dhe e jashtme (fasadave) të institucioneve arsimore. E planifikuara për tri vite, në vlerë prej 889,750.00€. Deri më tani kontrata është përmbushur 5%, dhe për shkak të mungesës së buxhetit, po kemi vështësi edhe në ekzekutimin e punimeve sipas kontratës.


- Në fillim të vitit 2025 është kryer plani i zotimeve dhe shpenzimeve, pasqyra e ndarjes së buxhetit të shkollave për kategorinë e pagave dhe shërbimeve komunale të cilat i janë dërguar shkollave. DKA në bashkëpunim me drejtuesit e shkollave është përgatitur për fillimin e vitit të ri fiskal me udhëzimet që rrjedhin nga thesari.
- Janë realizuar zotimet e mjeteve për kategoritë ekonomike sipas kërkesave të shkollave. Deri në këtë periudhë janë zotuar **1160** lëndë, për të gjitha kategoritë shpenzuese si dhe janë përgatitur raporte periodike sipas nevojës për institucionet shkollore, përkatësisht janë njoftuar shkollat për buxhetin e alokuar dhe shpenzimet sipas kërkesave të tyre.
- Janë përpunuar ndryshimet në listat e pagave për periudhën janar- nëntor 2025 dhe janë procesuar kërkesat e shkollave sipas pasqyrës së mëposhtme, ku në bazë të këtyre të dhënave sektori i financave për këtë periudhë ka proceduar gjithsej **1581** lëndë.

Pasqyrë e realizimit të pagesave në sistem të pagave janar nëntor						
Muaj	Puntorë të rinjë	Pagesa retroaktive /ore jashtë orarit	Ndryshime	Tranfere bankare	Ndalesa në page	Largime nga lista e pagave
Janar	4	4	31	5	0	11
Shkurt	10	54	21	6	1	10
Mars	0	185	32	11	1	12
Prill	13	11	34	40	1	11
Maj	14	6	31	9	1	6
Qershor	0	53	20	6	0	3
Korrik	13	101	31	1	0	11
Gusht	15	16	8	3	1	16
Shtator	12		63	3	1	12
Tetor	17	150	71	6	1	10
Nëntor	14	153	17	6	0	8
Dhjetor	9	122	22	4	0	7
Gjithsej	<u>121</u>	<u>855</u>	<u>381</u>	<u>100</u>	<u>7</u>	<u>117</u>
						<u>1581</u>

- Drejtorja e arsimit ka pasur sfidat e veta lidhur me sistemin e stafit të arsimit në kohë ku kanë qenë evidente shkurtime të buxhetore në numër si dhe mjete për stafin për zëvendësim të pushimeve mjekësore, të lindjes etj.


- Në bazë të raportit përmbledhës të shpenzimeve të institucioneve shkollore deri në këtë periudhë janë bërë pagesa me vendime gjyqësore nga buxheti i Drejtorisë së arsimit përkatësisht nga kodi i investimeve kapitale janë ekzekutuar vendimet gjyqësore me vlerë 600000€ ndërsa nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve 463,625 € me vlerë totale rreth 1,063625€ . Këto ekzekutime kanë vazhduar të dëmtojnë buxhetin e arsimit me vite dhe do të vazhdojnë duke pasur parasyshë njoftimet për vendimet gjyqësore që kane ardhur .
- Në kuadër të angazhimit të sektorit të financave në bashkëpunim me zyrtarin kryesor financiar, DKA iu është përgjigjur kërkesave të auditorit në lidhje me pagesat me vendime gjyqësore të vitit të kaluar.
- Ka vazhduar bashkëpunimi me zyrtarë të departamentit të buxhetit lidhur me të dhënat e kërkuara për stafin aktual dhe janë përcjellur pasqyra me të dhënat e kërkuara.
- Është përfunduar procesi I planifikimit të buxhetit 2026-2028 në të cilën janë evidentuar kërkesat buxhetore të shkollave sipas qarkoreve buxhetore 2025 në sistemin e zhvillimit dhe menagjimit të buxhetit (SZHMB)
- Me përfundimin e vitit fiskal sektori i financave ka analizuar gjendjen mbi ecurinë e shpenzimeve në arsimin parafillor, fillor dhe të mesëm përkatësisht realizimin e buxhetit dhe ka përgatitur pasqyrën e shpenzimeve ku janë paraqitur të dhënat e shkollave për realizimin e buxhetit sipas planifikimit. Kjo pasqyrë dukshëm paraqet dëmet që i janë shkaktuar DKA-se nga vendimet përmbartimore të cilët në vazhdimsi kanë goditur mosrealizimin obligimeve të projekteve për furnizim dhe shërbime të cilët kanë qenë të kontraktuara.
- Shpenzimet nga **granti qeveritar dhe te hyrat për të mallrat dhe shërbimet** për programin e arsimit janë realizuar mbi 97 % të cilat janë paraqitur sipas tabelës dhe grafikut të poshtëshënuar:

Përshkrimi	Buxheti I alokuar	Shpenzimet	Zotimet/obligimet e papaguara	Perqindja e shpenzimeve
ADMINISTRATA	893,754.00	870,395.97	23,318.32	97.4
ARSIMI PARAFILLOR DHE ÇERDHET	20,000.00	17,562.46	2,437.54	87.8
ARSIMI FILLOR	826,443.00	813,093.52	13,231.96	98.4
ARSIMI I MESËM	165,373.00	161,847.87	2,637.49	97.9
21 TË HYRAT VETANAKE	400,000.00	394,103.64	3,020.99	98.5
22 TË HYRAT VETANAKE NGA VITI I KALUAR	129,882.11	129,810.61	71.50	99.9




Ndërsa përqindje e shpenzimeve për paga është si në tabelën e mëposhtme

Përshkrimi	Buxheti Aktual	Alokuar	Shpenzimet	Përqinda e realizimit
92050 ADMINISTRATA - PRIZREN	130,421.29	130,421.29	130,421.29	100
92390 ARSIMI PARAFILLOR DHE ÇERDHET- PRIZREN	452,160.89	452,160.89	452,160.89	100
93270 ARSIMI FILLOR - PRIZREN	16,388,326.36	16,388,326.36	16,385,987.05	100
94470 ARSIMI I MESËM - PRIZEREN	3,433,332.08	3,433,332.08	3,433,332.08	100
21 TË HYRAT VETANAKE	70,000.00	70,000.00	70,000.00	100
22 TË HYRAT VETANAKE NGA VITI I KALUAR	45,000.00	45,000.00	45,000.00	100



Për investime kapitale

Përshkrimi	Buxheti Aktual	Shpenzimet	Zotimet/obligimet e papaguara	Përqindja e shpenzimeve te Inv kapitale
92390 ARSIMI PARAFILLOR DHE ÇERDHET- PRIZREN	400,000.00	350,000.00	50,000.00	87.50
93270 ARSIMI FILLOR - PRIZREN	2,068,655.00	2,051,237.48	1,939.34	99.16
94470 ARSIMI I MESËM - PRIZEREN	18,218.00	18,218.00	0.00	100.00



Shpenzimet në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve si dhe ato kapitale për të gjitha programet janë evidentuara sipas të dhënave të lartëshënuara.

Në këtë përqindje janë të përfshirë shpenzimet përmbarimore të cilat e kanë dëmtuar buxhetin e arsimit në masë të madhe.